



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.216/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Hasan Shala dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3.200,00 (tremijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 13.10.2017, me të cilën pretendon se me datën 12.10.2017 kandidati për kryetar të komunës së Podujevës Agim Veliu nga subjekti politik LDK ka publikuar fotot e tubimit të mbajtur në Shtedime të Podujevës, ku gjatë këtij tubimi vërehet prezenca e personave nën moshën 18 vjeçare. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës zgjedhore 13/2013 që ndalon përfshirjen e personave nën 18 vjet në fushate.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotot e postuara nga faqja zyrtare e facebookut të kandidatit në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik LDK, të datës 14.10.2017, theksohet se ankesa në fjale është e pabazuar, pasi që nga fotot e bashkangjitura ankesës vërehet se personat në foto janë të rritur dhe nuk mund të trajtohen sikur të mitur nën moshën 18 vjeçare. I njëjti thekson se nga bisedat e zhvilluara me zyrtaret e LDK-së në Podujevë të njëjtit kanë konfirmuar se në takimin në fjalë nuk kishte persona të mitur nën moshën 18 vjet, por se pavarësisht kësaj subjekti politik LDK ka kërkuar që të largohen fotot nga rrjeti social me qëllim që të mos krijohen keqkuptime.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografit e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Agim Veliu, kandidat për Kryetar të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik LDK, ka publikuar në rrjetin e tij social të facebookut tubimin zgjedhor të mbajtur në fshatin Shtedime të Podujevës ku në këtë tubim shihen fëmijë të moshës nën 18 vjet, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik LDK, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Paneli gjatë vendosjes pati parasysh edhe pretendimet në përgjigjen e pranuar ku pretendohet se personat në foto nuk mund të trajtohen si të mitur nën moshën 18 vjet, këto pretendime paneli i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se janë në kundërshtim me provat e lëndës. Dispozita ligjore e nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së, përcakton qartë se personat të cilat nuk i kanë mbushur moshën 18 vjet nuk mund të përfshihen në fushatën zgjedhore të asnjë subjekti politik të certifikuar për zgjedhje. Nga fotografit e ofruara si dëshmi shihen qartë pjesëmarrja e fëmijëve të mitur gjatë fushatës zgjedhore subjektit politik LDK.

Andaj, me këtë rast kandidati në fjalë ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ligjor duke bërë fushatë zgjedhore me fëmijë të mitur nën 18 vjet, veprim i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Zl.Anr. 216/2017 më datën 16.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Gylten Sylajman



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.